

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizrena "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dat. 08.07.2022	
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-315/A



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000
Prizren, Republika e Kosovës
www.uni-prizren.com

RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË ETIKËS PËR KËRKIME SHKENCORE

Prizren, 2022



Bazuar në dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë Nr. 04/L-037, Ligjit mbi të Drejtat Autoriale Nr. 04/L-065, Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, Strategjinë e Universitetit mbi Kërkimet Shkencore 2020-2024, Kodin e Etikës Nr. 01-195/A, dhe Rregulloren mbi Kërkimet Shkencore Nr. 01-59/A, Këshilli Drejtues i Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, në mbledhjen e mbajtur më datë: 30.06.2022, miraton këtë:

RREGULLORE PËR THEMELIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT TË ETIKËS PËR KËRKIME SHKENCORE

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Me këtë Rregullore përcaktohet krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Etikës në Kërkime Shkencore në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.
2. Kjo Rregullore definon dhe përcakton kushtet dhe procedurat e themelimit dhe funksionimit të Komisionit të Etikës në Kërkime Shkencore në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.

Neni 2

Qëllimi i Rregullores

Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren (Universiteti në vazhdim) është i përkushtuar për avancimin e punës kërkimore-shkencore dhe sigurimin e cilësisë, dhe e gjithë puna e stafit akademik të Universitetit kryhet në përputhje me praktikat më të mira dhe parimet etike. Për këtë qëllim, Komiteti i Kërkimit Shkencor dhe Etikës (KKSHE) i krijuar në nivel universitar luan një rol udhëheqës për të garantuar monitorimin e punës kërkimore-shkencore të kryer në universitet nga studiuesit (stafi akademik), studentë dhe palë të treta.

Neni 3

Kuptimi i etikës në hulumtim

Etika në hulumtim nënkupton zbatimin e parimeve thelbësore në veprimtarinë e punës kërkimore-shkencore, duke përfshirë hartimin dhe zhvillimin e kërkimeve shkencore, respektin ndaj shoqërisë dhe të tjerëve, shfrytëzimin e drejtë të burimeve dhe rezultateve kërkimore, si dhe shkeljet e etikës në hulumtime shkencore.

Etika në shkencë përfshin dy aspekte kryesore. Nga njëra anë, është zbatimi i standardeve etike në fushën specifike të shkencës dhe veprimtarisë shkencore për të vlerësuar dhe rregulluar sjelljen dhe marrëdhëniet në të si dhe për të analizuar dhe për të zgjidhur të gjitha problemet e vlerave tashmë të shfaqura. Nga ana tjetër, etika në shkencë është etika profesionale e shkencëtarëve, e cila sistemon vlerat dhe standardet bazë të sjelljes, si dhe të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre si profesionistë.



OBJEKTIVAT, FUNKSIONET DHE PËRGJEGJËSITË E KKSHE

Neni 4 Objektivat

Objektivi themelor i KKSHE është të përcaktojë kërkesat dhe standardet për zhvillimin etik të kërkimit në Universitet, duke mbikëqyrur nëse praktika kërkimore e kryer nga studiuesit, studentët ose palët e treta në mjediset e universitetit, e që rezultatet e saj të jenë në përputhje me standardet e etikës së kërkimit për autoritetin drejtues.

Neni 5 Detyrat

KKSHE ka këto detyra:

1. Të formulojë dhe të përcaktojë politikat, procedurat dhe dokumentet në lidhje me punën kërkimore-shkencore dhe të sigurojë që këto politika të zbatohen brenda fushave të përgjegjësisë;
2. Të promovojë dhe auditojë ndërgjegjësimin për legjislacionin përkatës dhe parimet etike që rregullojnë praktikën kërkimore;
3. Të nxisë një mjedis që inkurajon marrjen e një qasjeje të përgjegjshme dhe etike në të gjitha fushat e kryerjes së kërkimit dhe praktikave të botimit;
4. Të identifikojë nevojat arsimore në mesin e anëtarëve të komisionit dhe studiuesve në lidhje me çështjet etike dhe të ofrojë seminare dhe trajnime për adresimin e tyre;
5. Të rishikojë praktikat më të mira në kërkime dhe të marrë në konsideratë zhvillimin e politikave etike dhe promovimin e edukimit brenda Universitetit në çështjet e etikës dhe integritetit të kërkimit;
6. Të shqyrtojë dhe raportojë për të gjitha aplikacionet e dorëzuara për rishikim etik duke u siguruar që praktikat e kërkimit të përmbushin standardet e përgjithshme etike të vendosura brenda Universitetit;
7. Të analizojë rezultatet e veta për qëllime të vlerësimit të cilësisë dhe përmirësimit të cilësisë;
8. Të përcaktojë rregullat e përhershme lidhur me qeverisjen, kuorumin dhe kryesinë.

Neni 6 Funksionet

KKSHE ka këto funksione:

1. Të nxisë një kulturë etike kërkimore midis komunitetit të Universitetit që respekton rekomandimet e praktikave më të mira të përcaktuara në politikat, procedurat dhe udhëzimet e Universitetit, të cilat rregullojnë praktikën kërkimore dhe detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës;
2. Të ofrojë udhëzime të qarta dhe lehtësisht të qasshme mbi praktikat më të mira etike dhe kërkesat rregullatore;



3. Të ofrojë mbështetje dhe trajnime për stafin, studentët dhe palët e treta që të angazhuara në projektet kërkimore Universitare në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit dhe ruajtjes së standardeve të larta etike në praktikën kërkimore;
4. Të ruajë procesin e rishikimit etik i cili lejon që projektet kërkimore t'i nënshtrohen një nivel shqyrtimi në raport me rrezikun etik;
5. Të mbikëqyrë zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe praktikave kërkimore të Universitetit, duke ndërmarrë veprime të duhura aty ku ka prova për sjellje të pahijshme kërkimore.

Neni 7 Përgjegjësitë

Përgjegjësitë e KKSHE- së janë:

1. Të veprojnë në interes të plotë të pjesëmarrësve në kërkim dhe komuniteteve;
2. Të marrë parasysh nevojat e studiuesve dhe kërkesat e agjencive rregullatore përkatëse dhe ligjet në fuqi;
3. Të zhvillojë rishikim të pavarur, kompetent dhe në kohë të kërkimit të propozuar për publikim dhe të sigurohet që ka një vlerësim të rregullt të etikës së projekteve kërkimore.

Neni 8 Zgjedhja dhe funksionimi i KKSHE

1. Përzgjedhja e anëtarëve të KKSHE:
 - 1.1. KKSHE-ja zgjidhet nga Senati i Universitetit, me mandat katër vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat tjetër. Anëtarët e komisionit emërohen nga secila njësi akademike në Senat.
 - 1.2. KKSHE-ja përbëhet nga 9 anëtarë, duke përfshirë një përfaqësues nga çdo njësi akademike, si dhe një përfaqësues të personelit administrativ dhe një student.
 - 1.3. KKSHE-ja përfshin edhe anëtarë të jashtëm nga institucione/organizata të ndryshme të lidhura me universitetin;
 - 1.4. KKSHE-ja i raporton Senatit dy herë në vit.
 - 1.5. Të gjithë anëtarët pritet të respektojnë politikën dhe procedurat e funksionimit të KKSHE-së.
2. Anëtarët e KKSHE-së pritet të:
 - 2.1. Ndihmojnë në zhvillimin dhe zbatimin e standardeve dhe praktikave më të mira etike në të gjitha aktivitetet kërkimore të ndërmarra brenda Universitetit;
 - 2.2. Veprojnë për të promovuar ndërgjegjësimin për politikën dhe procedurat etike të Universitetit, për të lehtësuar anëtarët e Universitetit që të paraqesin kërkesa të përshtatshme (publikime shkencore) dhe të këshillojnë për çështje etike që lidhen me aplikimin e tyre;
 - 2.3. Të shqyrtojnë, të vendosin dhe të raportojnë për çështjet etike që lidhen me të gjitha kategoritë e studimeve kërkimore të ndërmarra në Universitet;
 - 2.4. Lehtësojnë një rishikim dhe diskutim të vazhdueshëm mbi çështjet etike.
3. Anëtarët e KKSHE-së janë të detyruar të përmbushin kushtet si në vijim:



- 3.1. Anëtarët duhet të marrin pjesë rregullisht në mbledhje;
- 3.2. Anëtarëve u kërkohet të dërgojnë arsyetim me email në zyrën e Etikës së Kërkimit nëse nuk janë në gjendje të marrin pjesë;
- 3.3. Anëtarëve u kërkohet të japin komente me email mbi rishikimet, shqyrtimet e aplikacioneve dhe çdo çështje tjetër relevante të kërkuar nga Kryetari i KKSHE-së;
- 3.4. Puna e KKSHE duhet të kryhet përmes një sistemi zyrtar komunikimi universitar. Anëtarët priten ta përdorin këtë sistem në një mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme për arsye sigurie;
- 3.5. Anëtarët që nuk japin kontribut në punën e KKSHE, ose nuk marrin pjesë në tri mbledhje radhazi, mund të zëvendësohen nga Senati sipas propozimit të kryetarit të KKSHE.
- 3.6. Nëse ndonjë nga anëtarët e KKSHE jep dorëheqje ose shkarkohet nga Këshilli, ai duhet të zëvendësohet nga një anëtar tjetër i së njëjtës njësi akademike, me propozimin e Këshillit të njësisë akademike dhe miratimin e Senatit. Procedura e zëvendësimit është e njëjtë me procedurën e formimit/emërimit vetëm për mandatin e mbetur.
- 3.7. Anëtarët kanë përgjegjësi të deklarojnë çdo konflikt interesi që mund të ndikojë në rolin dhe performancën e tyre dhe të deklarojnë mungesën nga diskutimi përkatës gjatë mbledhjes.

Neni 9 Dorëheqja

Anëtari i KKSHE-së për dorëheqje duhet të njoftojë me shkrim kryetarin e Komisionit për qëllimin e tij/saj për të dhënë dorëheqjen. Anëtari i KKSHE-së që jep dorëheqjen duhet të hiqet nga të gjitha listat e komunikimit të KKSHE-së dhe të zëvendësohet me një anëtar tjetër.

Neni 10 Kuorumi

Kuorumin e mbledhjes e përbëjnë 5 anëtarë të pranishëm (nga 9). Mbledhja e KKSHE-së duhet të ketë një numër të mjaftueshëm të pranishmëve për të vazhduar me rendin e ditës.

Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Drejtues të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

**Kryesuesi i Këshillit Drejtues
Prof. Asoc. Dr. Arif Murrija**